



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.06.2016** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**. Konstatohet se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes, në mbledhje të kuvendit kanë janë të pranishëm 29 Kuvendarë, 2 mungojnë.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e komunës z. Idriz Vehapi, Nënkryetarin e Komunës z. Xhemali Haxhimustafa Drejtorët e drejtorive, monitoruesin e KDI-së, monitoruesit e KFORIT, mediat, këshilltarët e pranishmëm dhe gjithë të pranishmit. Për mbledhjen e sotme propozoj këtë:

Rend Dite

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e kaluar,**
2. **Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët komunal,**
3. **Shqyrtimi i KAB-it 2017 – 2019 (Qarkores së parë Buxhetore),**
4. **Shqyrtimi dhe aprovimi i draft rregullores për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në komunën e Rahovecit.**
5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për aprovimin e propozimit të Kryetarit të komunës për shpalljen e interesit të përgjithshëm, shpronësimin e pronës së paluajtshme,**
6. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për aprovimin e propozimit të Kryetarit të komunës për sigurimin e tokës urbane për qëllime të interesit publik,**
7. **Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të Kryetarit të komunës për dhënien e pronës së paluajtshme në Shfrytëzim,**
8. **Informim lidhur me shlyerjen e obligimeve të mbetura nga shfrytëzuesit e pronës komunale,**
9. **Zëvendësimi dhe Plotësimi i Komitetin për Politik dhe Financa dhe Komitetin për Shërbime Publike Komunale me anëtar të ri.**

Kryesuesi – E kemi një ndryshim nga radhët e këshilltarëve të PDK-së, znj. Beatrisa Demiri është larguar nga pozita e këshilltares pasi është emëruar Drejtoresh në shkollën e fillore Bekim Sylka dhe ka konflikt interesi, KQZ-ja ka certifikuar delegaten e radhës nga radhët e PDK-së znj. Hirishahe Sylka të cilën e ftoj që të jepe betimin.

Hirishahe Sylka – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit Unë, Hirishahe Sylka , “betohem se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesi – E qes në aprovim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

E qes në aprovim Procesverbalin: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Ne grupi i PDK-së deri tani e kemi pas anëtare të KPF-së Beatrisa Demirin dhe në vende të Beatrisës e propozojmë Qazim Qeskën si anëtar të ri të KPF-së, ndërsa në Komitetin për Shërbime Publike ka qenë anëtar Ejup Kabashi, në vend të tij ne e propozojmë Elvedina Canën si anëtare të re të Komitetit për Shërbime Publike.

2. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve,

Fatmir Iska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Pyetja e parë është për Drejtorin e Shërbimeve Publike: Janë krijuar disa gropa në rrugët e qytetit të Rahovecit, posaçërisht tek semaforët kishte me qenë mirë

të mirën masa për sanimin e tyre. Pyetja dytë është për Drejtorin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim: A janë përgatitë për sezonin verorë, të gjithë e dimë se në sezonin verorë mundet të ketë zjarre nëpër pyje, pra sa janë përgatitur si drejtori nëse do të ketë ndonjë raste.

Rukije Krasniqi – Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, i falënderoj drejtorët për përgjigjet që na kanë kthyer në kopje fizike është mirë që të vazhdohet kështu. Pyetje ime e parë është për Drejtorinë e Arsimit: Shqetësimi i Mësimdhënësve është tek përmisimi i notave që është duke u bërë me presion të vazhdueshëm nga prindërit tek mësimdhënësit. Kemi prindër të cilët në mënyrë të vazhdueshme javët e fundit janë duke ardhur vazhdimisht në shkollat tona duke bërë presion tek mësimdhënësit rreth përmisimit të notave për fëmijët e tyre nga 11 njisha fëmijët e tyre kalojnë pastër, ndërsa në anën tjetër kemi nxënës që i kanë 1 ose 2 njisha dhe mbesin në riprovim sepse prindërit e tyre nuk bëjnë presion për përmisim. Po ashtu nëse përsërit klasën një nxënës mësimdhënësit janë të kërcënuar nga prindërit ose të afërmit e nxënësve. Kërkojmë nga organet kompetente të Drejtorisë së Arsimit që të marrin masa për këtë fenomen sepse jemi duke nxjerrë gjysmë analfabetë me certifikata dhe vlera e arsimit çdo ditë është duke rënë. Pyetja e dytë është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: Sa është duke u mirëmbajttë parku i cili gjendet zonën e Drenocit në të cilin kemi mbjeddë 122 pisha në emër të dëshmorëve të komunës së Rahovecit, kjo ka ndodhur në mandatin e Qazim Qeskës, pra si është gjendja e këtij parku a është duke e mbikëqyrë dikush këtë park. Veprimtaria për mirëmbajtje të mjedisit është zero.

Rexhep Oruçi – Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime shkon për Kryetarin dhe Ekzekutivin: Unë kisha me ngritë një shqetësim jo vetëm timin por edhe një pjese dërmuese të qytetarëve të qytetit të Rahovecit lidhur me furnizimin e ujit të pijes për pjesën e epërme të qytetit e cila i ka ma shumë se 5.000 banorë, kjo lagje ka telashe permanente me furnizim të ujit të pijes. Kjo dukuri sidomos ka ardhë në shprehje pas marrëveshjes që komuna e Rahovecit e ka bërë me kompaninë e Radoniqit për pagesën energjisë elektrike për pompat thithëse që janë të vendosura në pompat poshtë. Me këtë marrëveshje në një formë ne si komunë kemi fituar por kjo siç duket është në dëm të qytetarëve. Ndoshta është dashur të formohet një grupe punues dhe të shkojë të bisedoj me zyrtarët e Radoniqit dhe të zgjidhet ky problem sepse kjo është gjynah i zotit në këto ditë vere mos të kemi ujë të pijes. Sipas disa informatave që kam marrë nga një punëtor i Radoniqit sipas tij ata janë duke kursyer energji elektrike prandaj nuk ka furnizim me ujë në lagjen e epërme.

Sinan Bajraktari – Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, Pyetja ime e parë shkon për Drejtorin e Arsimit: Në muajin qershor në shkollën fillore Milaim Krasniqi në Pastasel është emëruar një ushtrues detyre të drejtorit të shkollës, mirëpo të njëjtën kohë si ndihmës i drejtorit ka vazhduar ishe drejtoresha e shkollës e cila nuk e ka ditë as vetë se çfarë funksioni ka po ashtu as ne si kolektiv nuk e kemi ditur. Pyetja ime është deri kur do të jetë në listë të pagave ish drejtoresha në këtë shkollë. Pyetja e dytë është për Drejtorin e Inspektoratit: Kohëve të fundit në rrugën Kramovik – Ratkoc janë rregulluar disa gropa të që janë mirëpritur nga qytetarët, por pjesa e trotuareve ka mbete e pa rregulluar, kubëzat që kanë mbete mbi trotuar nuk është duke u marr askush me to. Kërkoj nga Drejtoria e Inspektoratit që të dalin ma shpesh në atë rrugë dhe të japin gjoba për personat që e dëmtojnë atë rrugë sepse brenda një muaji 3 – 4 ndërhyrje në rrugë ka.

Kryesuesi – Kjo rrugë është në fazën e tenderimit dhe shumë shpejtë do të rregullohet.

Afrim Limani - Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, Pyetja ime e parë është për Drejtorin e Bujqësisë: Në kuadër të kësaj drejtoria ka qenë një projekt shpërndarja e serave, pyetja ime është se me çfarë kriteri janë bërë shpërndarja e serave, komisioni a ka vepruar në mënyrë të pavarur apo ka qenë i ndikuar nga jashtë. Gjithashtu ju keni deklaruar para qytetarëve se në kuadër të këtij projekti do të bashkëngjitet edhe një shoqatë e huaj e cila do të participoj me disa sera, dua ta di a ka lëvizje në këtë drejtim. Pyetja e dytë shkon për drejtorin e shërbimeve publike: A ka ndonjë shpresë se brenda këtij viti do të furnizohen me ujë të fshatrat Polluzha dhe Guri i Kuq.

Florije Boshnjaku – Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, Kam një propozim për të bërë: Kam dëgjuar se ish punëtoresha Xhizide Zllanoga i ka vdekur djali, a ka mundësi që të i ndihmojë Kryetari me një shumë të mjeteve aq sa ka mundësi sepse kjo zonjë nuk e ka gjendjen ekonomike të mirë.

Besnik Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Pyetja ime e parë është për Drejtorin e Shërbimeve Publike: Kur do të rregullohet ndriçimi publik në Ratkoc sepse nga 32 ndriçues vetëm 3 janë në funksion. Pyetja e dytë është për Drejtorin e Administratës: Në zyre të vendit në Ratkoc ka disa ditë që nuk ka certifikata dua ta di ku është problemi që nuk ka.

Kadri Dellova – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime shkon për Drejtorin e Shërbimeve Publike: Lagjja Janina në Krushe të Madhe ka që dy javë që ka një hallë të madhe, aty ka shpërthyer gypat e kanalizimit, kompania e Radoniqit e cila është përgjegjëse për mirëmbajtje nuk ka marr kurrfarë masa, sot kam qenë me e vizituar atë vend dhe gjendja ishte e mjerueshme, prandaj kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe e Inspektoratit që ta dërgojnë një ekspert të drejtorisë së shërbimeve publike dhe një inspektor sanitarë që të shkojnë në atë lagje dhe të ndërmarrin masa sa më shpejtë para se të përhapet ndonjë epidemi. Pyetja e dytë shkon për Drejtorin e Inspektoratit: Kohëve të fundit Kompania e Radoniqit shpesh herë e ndalë ujin në mënyrë të pa kontrolluar edhe pse merë taksat një herë në muaj për çdo orë matës, ata nuk i rregullojnë ato daljet sekondare dhe detyrohen çdo javë të bëjnë prishje të rrugës dhe gropat që i bëjnë nuk janë duke i sanuar. Prandaj i ftoj inspektorët që të dalin në vendin e ngjarjes.

Bahtjar Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Pyetja ime shkon për Drejtorin e Inspektoratit dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike: Shtrati i proit biqevc në Ratkoc, aty ka shpërthyer kanalizimi nga poshtë dhe e ka prishë shtratin, dua ta di a kanë qen me studioju gjendjen Drejtoria e Inspektoratit se si ka ardhë deri tek kjo dhe a ka kompani për sanimin e këtyre defekteve. Pyetja e dytë është a kishte me pas mundësi të bëhet një kërkesë tek Stacioni Policor i Rahovecit për shpeshimin e patrullave në zonën e Ratkocit sepse vërehet fluksi i mërgimtarëve që kanë ardhë, kemi ankese nga qytetarët e asaj ane sepse ka vozitje të shpejtë.

Xhafer Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime shkon për Drejtorin e Shërbimeve Publike:, Fshati Dejnë është pika më e ulët e lartësisë mbidetare në reshtin e fshatrave Gradish – Kramovik, për shkak kësaj kemi pas gjithmonë probleme me ujërat e zeza, viteve të 90-ta ka pas disa investime vetanake po ashtu edhe pas lufte ka pas disa investime nga disa organizata të huaja, problemi ekzistues është në përfundim të rrjetit të kanalizimit ku ka qenë një projekt për një gropë septike mirëpo sipas gjendjes që është aty dhe sipas informatave që kam ajo gropë nuk është bërë ashtu si duhet. Një diskutim që pata pak më parë me drejtorin më tregoj se është një përgatitje për me e sanuar atë problem, por unë desha të shtoj që ka disa pjesë të fshatit që nuk janë të përfshirë në rrjetin e kanalizimit kishte me qenë mirë që të bëhet një inspektim i këtij rrjeti në mënyrë që mos të ketë më probleme me kanalizim. Gjithashtu në rreth rrotullimin e fshatit Ratkoc nuk ka sinjalizim horizontal dhe vija të bardha për këmbësor, mendoj se është rrezik potencial që të ndodhë ndonjë fatkeqësi eventuale, kishte me qenë mirë që edhe kjo të rregullohet sa më shpejtë.

Hysni Gashi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Unë e kam një rekomandim për Drejtorin e Inspektoratit, shumë fshatra kanë nga një lumë që i kalon në fshat, sugjeroj drejtorin e inspektoratit që të del me vërejtje për çdo fshat që ka lumë që ti paralajmëroj qytetarët që mos të hedhin mbeturina në lumë ose ti jepe gjobë atyre që hedhin mbeturina sepse në shumë fshatra ashtu si në fshatin time gjendja e lumenjve është e mjerueshme, në vend se të jemi të privilegjuar që kemi lumë në fshat ne i degradojmë.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, do të tentoj të japë një përgjigje për shqetësimin e këshilltarit Rexhep Oruçit që është ngritë ne emër të qytetarëve të zonës së 3 të qytetit të Rahovecit. Hiq më larg se ditën e hënë e kemi diskut me Kryetarin në mbledhjen e ekzekutivit. Arsyetimi i Radoniqit është se furnizimi i basenit të 3600 m³ që është afër majës së shkodranit është i mjaftueshëm për atë lagje por kapaciteti i pompave që e shtynë ujin deri tek baseni është shumë i vogël. Është premtuar nga Radoniqi se kësaj vere do të bëjnë zëvendësimin e atyre pompave, po ashtu do të bëjnë disa intervenime në ventilet ndaluese dhe lëshues të ujit në zonën e 3 për arsye mos të përzihet uji me zonën e 2 dhe atë të 3, pra kjo është përgjigjja e tyre. Ne si ekzekutiv kemi marrë një qëndrim kështu: ku gojarisht ja kemi përcjellë drejtorit të Radoniqit por sot do i shkon edhe me shkrim që së paku të i njoftojnë qytetarët për kohën e reduktimit të ujit të pijes. Ne vitin e kaluar si komunë kemi intervenuar me shumën prej 20,000.00 € për një gyp shtesë që është futur nga baseni i parë në të dytin por siç po shihet edhe kjo nuk ka mjaftuar, kryesorja

është se ujë ka mjaftë por siç e thash më lartë pompat e ujit nuk janë në gjendje të shtynë ujin deri në bazën aq kapacitet sa i nevojitet.

Rasim Fazliu – Ne vetë kemi kërkuar nga Drejtorët që përgjigjet të na kthejnë me shkrimë por kjo mënyrë nuk po më pëlqen arsyeja është kjo, nëse dikush nga këshilltarët e ka ngritë një shqetësim dhe drejtori ja ka kthyer atij përgjigjen dhe unë si këshilltar prapë mundem me pyet për atë problem sepse nuk e di përgjigjen. Kishte me qenë mirë ndoshta drejtorët krahas përgjigjeve me shkrimë të dalin në foltore para kuvendarëve që të i përgjigjen pyetjes në mënyrë që të gjithë kuvendarët të njoftohen me përgjigjet.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë pranishmit në sallë, sa e di unë është një rregull nëse parashtuesi i kërkesës kërkon përgjigje me shkrimë atëherë duhet paraprakisht me ju adresu me shkrimë, por nëse i drejtohet për përgjigje me gojë atëherë zyrtari është i obliguar me ju përgjigj me gojë. Po ashtu do i përgjigjem Afrimit sa i përket pyetjes për shpërndarjen e serave. Afrim ka pas një komision dhe sa e di unë kriteret kanë qenë së pari familjet që janë në nevojë dhe familjet që i kanë të humbur të afërmit në luftë, sa i përket asaj organizate që e përmende nuk ka të bëjë asgjë me këtë projekt, ky projekt ka qenë shtesë, ka qenë një premtim nga shoqata TIKA turke por ende nuk ka diçka konkrete.

Afrim Limani – Kryetar pe marrë shembull fshatin time 80% të rasteve është shpërnda sipas kriterëve por 20% të serave nuk janë shkuar aty ku duhet, për këtë arsye e bëra pyetjen.

Sali Sallteku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kuvendari Besnik Hoti pyeti në lidhje me mungesën e certifikatave në fshatin Ratkoc, është e vërtetë se në fillim të muajit kemi pas një problem ose një mungesë të certifikatave, certifikatat na vinë neve përmes ministrisë por deri tek kjo ka ardhur për shkak se kemi pas një fluks të madhe të nxjerrjes së certifikatave nga veteranët e luftës por besoj se tani e tutje më nuk do të kemi probleme sepse jemi furnizuar mjaft nga ana e ministrisë.

Kryesuesi - Kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i KAB-it 2017 – 2019 (Qarkores së parë Buxhetore),

Lulzim Sylejmani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Planifikimi i qarkores së parë buxhetore si dhe planifikimi i të hyrave vetanake nga ana e ministrisë për ne është e përealizueshëm. Kjo është një sfidë e veçantë sepse një planifikim i tillë duhet të vendoset nëpër kategori edhe për shpenzime, ku konkretisht të hyrat vetanake mbi 85 % shkojnë për projekte kapitale dhe nëse vendosim ne shifra që nuk mundemi me i arit atëherë para juve si kuvendarë dhe para qytetarëve nuk do të jemi të sigurtë lidhur me realizimin e projekteve që do të realizohen gjatë vitit 2017. Nëse kjo në qarkoren e dytë do të shqyrtohet nga MF atëherë kategoria që do të pësojë zvogëlim është kategoria e investimeve kapitale. Buxheti për vitin 2017 në paga dhe mëditje është i planifikuar 6,930,098.00 €, investime kapitale 3,737,271.00 €, mallra dhe shërbime 716,110,00 €, komunal 255,260.00 €, subvencione dhe trafaret 270,000.00 €. Për dallim nga vitet e tjera kemi rreth 300,000.00 € rritje në kategorinë e kapitaleve, pastaj kemi një rritje simbolike rreth 25,000.00 € tek mallrat dhe shërbimet, në komunal kemi një zvogëlim në këtë vit për arsye se pompat e ujit furnizuese kanë kaluar në menaxhimin e radoniqit dhe ne tani më nuk kemi obligim financiar për pagesën e rrymës, kërkesa jonë për MF është që të roitën subvencionet sepse në këtë vit kemi pas një sfidë ta madhe për plotësimin të gjitha kërkesave që na janë adresuar. Gjatë planifikimit të të hyrave vetanake kemi mbajtur takim me të gjithë drejtorët ku kemi parë se kërkesa në bazë qarkores është në rritje dhe kemi pas problem se ku të i vendosim ato, ku mundemi me realizu ma shumë se sa që kemi realizuar këto vite, e vetmja kategori që na ka dalë që nuk ka qenë vitet e kaluara është legalizimi i objekteve pa leje që është në procedurë e sipër, pra kjo është e vetmja kategori që mundet me na prodhu të hyra. Mendoj që ministria duhet të ketë parasysh që në qarkoren e dytë të i ndihmoj komunave në të hyrat vetanake që mos të jetë ndonjë sfidë e përealizueshme.

Florije Boshnjaku – Qysh në vendim i kamë parë disa gabime teknike dhe profesionale, në pjesën hyrëse thotë propozimi i Kryetarit të komunës kurse numri i protokollit nuk ka, në mbledhjen e mbajtur merë këtë vendim. Në nenin 1 thuhet me këtë miratohen kufijtë buxhetorë, kornizat afatmesme buxhetore sipas qarkores së parë 2017/1 për vitin 2017 – 2019 me numrin e protokollit 01/966, dua ta di ku e kanë marrë këtë nr. të protokollit. Pastaj edhe në komitet na keni treguar se në një pjesë të të hyrave vetanake kur është caktuar qarkorja buxhetore

kuvendi nuk pajtohet, duhet të thuhet që ky kuvend i rekomandon qeveris së Kosovës që të hyrat vetanake të i ndryshoj, pra cili është propozimi i qeverisë komunale dhe ne si kuvend a do të pajtohemi me atë propozim apo jo. Sa i përket buxhetit për vitin 2017 ma tepër isha lëshuar në këtë qarkore, pra a pajtohet ministria që të bëhet kjo shpërndarje në këto kategori ekonomike. Në hyrje të KAB-it nuk shkruan askund Komuna e Rahovecit, pastaj propozimi që na ka ardhë në Kuvend nuk ka asnjë emër se nga kush është propozuar a është nga drejtoria apo nga Kryetari, pastaj nuk ka asnjë vulë dhe asnjë nënshkrim. Në faqe nr.3 tek vendbanimet thuhet: Komuna e Rahovecit i ka 34 fshatra dhe qytetin, nuk i ka 35 me ligjin mbi kufijtë administrativ i ka 33 fshatra dhe qytetin ku bëjnë 34. Tek forcimi i ekonomisë komunale propozoj që të shtohet edhe ndërtimi i çerdheve për fëmijë sepse gjatë disa takimeve që i kam mbajte me gra në disa vendbanime ka pas kërkesa që të ketë një çerdhe në Krushë të Madhe dhe një në Ratkoc dhe në qytetin e Rahovecit ose të nderohen edhe një çerdhe tjetër ose të zgjerohet ajo ekzistuese. Tek të hyrat vetanake në shëndetësi këtë vite kanë qen të paraparë 49,000.00 € ndërsa për vitin e ardhshëm i keni paraparë 60,000.00 € unë nuk besoj se do të realizohet shuma e caktuar për këtë vite kurse shuma e cekur për 2017 është e parealizueshme. Në faqe nr.9, donatorët e jashtëm rregullimi i dy oborreve të shkollave 2015 – 2016 ne jemi duke biseduar për buxhetin 2017 besoj se është bërë ndonjë gabim teknik. Faqe nr.11 tek subvencionet pajtohem me ju që kërkonin ngritjen e subvencioneve sepse me të vërtetë qytetarët kanë nevojë për ndihmë, e pashë që subvencionet që do të afrohen për vitin 2017 janë në: bujqësi, dhe shëndetësi për shpërndarje të ilaçeve esenciale. Asnjëherë nuk ka shpërnda nga lista esenciale ato mjete që mungojnë qytetarëve, po ashtu nuk mundet nga subvencionet sepse janë kategori ose nga mallrat dhe shërbimet ose nga investimet kapitale. Ndihmë për shërim jashtë vendit, këtë komuna nuk mundet me e dhënë kjo bëhet nga Ministra e shëndetësisë. Propozoj që në këto subvencione për vitin 2017 të shtohet edhe subvencionimi i lehonave nga komuna e Rahovecit me vlerë prej 50 € - 100 €. Po ashtu të parashihen shpenzimet e varimit sepse nuk janë paraparë apo ndoshta do të dilni me një projekt prej investimeve kapitale, nëse janë nga subvencionet duhet të parashihen tek subvencionet. Në faqe nr.15 tek analiza gjinore, këtu vetëm i keni paraparë se sa femra janë të punësuar dhe sa janë të ardhurat për këto femra.

Selim Duraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndalem tek planifikimi i të hyrave vetanake tek drejtoria e urbanizmit dhe shërbimeve publike. Tek drejtoria e urbanizmit taksat komunale për leje ndërtimi kanë qenë të planifikuara 30,000.00 € ndërsa për këtë vite 18,000.00 €. Kurse Drejtoria e shërbimeve publike tek shfrytëzimi i pronës publike kemi një rritje të madhe, kurse qiraja dhe vendosja e objekteve të përkohshme kemi një zvogëlim prej 10,000.00 €. Dua ta di pse është bëtë kjo.

Afrim Limani – KAB-i si dokument nuk është i përgatitur mirë gjithashtu nuk është i analizuar mirë. ajo çka është ma e rëndësishme është se buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2017 po rritet në total prej 523,742.00 € ndërsa grandë po rritet 767,000.00 €. Problemi i cili na shqetëson neve është se investimet kapitale janë ka rriten për 328,000.00 €, unë i sha ndalur tek shpenzimet komunale dhe e kisha pyete Drejtorin pse janë zvogëluar me shumën prej 15,242.00 € mendoj se është problem me ja dalë me këtë limit deri në fund vite. Problemi tjetër që na shqetëson është rritja e të hyrave vetanake, është e pamundshme që komuna e Rahovecit ti realizoj 1,200,000.00 € të hyra duke i parë realizimit nga të hyrat paraprake. Ne duhet të caktojmë një farë limitë se sa mundet komuna e Rahovecit me i realizu të hyrat vetanake. Po ashtu mendoj se në investimet kapitale do të kenë rrënje deri në 200,000.00 € në bazë të këtyre limitëve që i kemi. Kur do të adresojmë kërkesën për në MF unë kisha dalë me një propozim që të hyrat vetanake të jenë po aq sa i kemi pas në vitin e kaluar.

Rukije Krasniqi – Në faqe nr.12 tek arsimi te shtylla e subvencioneve, ne e dimë se garat komunal janë duke u organizuar çdo vite pse mos të llogarisim ose të fusim në KAB edhe ndonjë shpërblim për fituesit e garave, besoj se do të jetë një motiv për nxënësit e tjerë po ashtu do të jetë gara me cilësore.

Hysni Gashi – Në faqe nr.4 tek kolona 2 thuhet përmissimi i ofrimit të shërbimeve të shëndetësisë dhe ofrimi i shëndetësisë mobile, a ka mundësi më konkretisht me na sqaru se çka do të thotë ofrimi i shëndetësisë mobile dhe a ka qenë ky shërbim në të kaluarën. Gjithashtu tek subvencionet në faqe 11 janë duke u përmendur subvencionet në bujqësi, kam një kërkesë që të caktohet si moto që çdo rrugë fushore të bëhet e kalueshme

dhe çdo parcelë ose tokë bujqësore të ketë qasja në rrugë sepse ende kemi parcela që kanë mbet pa qasje në rrugë.

Lulzim Sylejmani – Faleminderit për pyetjet e parashtruara nga kuvendarët. Sa i përket korigjimeve teknike që kanë qenë do të hiqen, po ashtu tek subvencionet do të hiqet pjesa e subvencionimit të barnave sepse furnizimi bëhet nga mallrat dhe shërbimet. Sa i përket investimeve kapitale unë e ceka në fillim që nëse do të ndryshohet planifikimi i të hyrave vetanake nga ky limit atëherë do të zvogëlohen kapitalet, po ashtu edhe propozimi i ynë gjatë diskutimit ka qenë që limitet përafërsisht të jenë limite të njëjta me vitin e kaluar ose 100,000.00 € më pak se sa në këtë vit, me të vërtetë është e pa arritshme shuma të cilën e ka planifikuar ministria, pse e ka planifikuar kështu ministria ka qenë çështja e shterjes së fondit monetar për shkak të rritjes së pagave dhe mos të zvogëlohet pjesa e kapitalëve. Tek donatorët kemi një kontratë me Demosin që e kapë vitin 2017 – 2018, po ashtu edhe me IOM-in planifikojmë që të vazhdojmë edhe në vitin 2018. Tek buxheti gjinor ne kemi nxjerrë statistika të gjendjes ekzistuese gjithashtu tani do të bëhet përshkrimi i një strategjie në nivel komune se si do të përkrahen ose subvencionohen aktivitetet e përfaqësimit gjinor, kjo gjithashtu do të bëhet edhe gjatë dëgjimeve buxhetore dhe gjatë aprovimit të buxhetit dhe shumë kërkesa që patëm këtu rreth çështjeve të projekteve do të përballemi gjatë dëgjimeve buxhetore dhe gjatë aprovimit të buxhetit këtu sot është vetëm korniza. Florije KAB-i dhe vendimi protokollohet mbase ta aprovoni ju dhe nuk ka pas nevojë të vije i protokolluar ndërsa sa i përket hyrjes të KAB-it do të vendosen shënimet të cilat i përmende ti.

Florije Boshnjaku – Drejtor në vendim thuhet me këtë miratohen kufijtë buxhetor, ne nuk jemi duke u pajtuar me këto kufij buxhetor, mendoj se duhet të jetë që Kuvendi merë vendim që të rekomandoj qeverisë të Kosovës që kategoria e të hyrave vetanake nga kjo shumë në këtë shumë, nëse ne pajtohemi me nenin 1 nuk mundemi me e ndryshu nenin 2.

Kryetari - Mendoj se ky është dokument standard dhe nuk besoj se ka ndonjë ndryshim nga vitet e kaluara vetëm nëse ka ndryshuar diçka ligji. I thërrasë përgjegjësit që janë që me standardizua, nëse shikojmë do të shohim se në çdo dokument ka një presja që e ndryshon ose e deformon fjalinë. Gabimet teknike përmissohen por struktura nuk besoj se ka ndryshuar.

Kryesuesi – E qes në aprovim kornizën afatmesme buxhetore 2017-2019, respektivisht qarkoren e parë buxhetore me rekomandimet që u dhanë që të hyrat vetanake të zbriten për 100,000.00 € në krahasim me këtë vit për vitin e ardhshëm, po ashtu edhe përmissimet e tjera që u cekën. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar KAB-i me rekomandimet e cekura më lartë. Kalojmë në pilën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i draft rregullores për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në komunën e Rahovecit.

Kjo draft rregullore ka kaluar në Kuvend në lexim të parë, po ashtu i ka kaluar të gjitha procedurat e debatit publik dhe sot ka ardhur prapë para jush në Kuvend që të aprovohet.

Gardalin Shtavica – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kjo rregullore është vendos në veb faqe të komunës me 26.04.2016, po ashtu i kemi mbajtur 3 debate në tri qendra më të mëdha si Rahovec, Krushe të Madhe dhe Ratkoc. Ka pas disa propozime ma shumë kanë qen teknike njëra prej tyre ka qenë hyrja falas në gjitha stadiumet e komunës së Rahovecit, pastaj hyrja falas në të gjitha shtëpitë e kulturës së Komunës së Rahovecit, pastaj propozim tjetër ka qenë regjistrimi i falës në të gjitha bibliotekat e komunës së Rahovecit që administrohen nga Komuna, pra këto kanë qenë rekomandimet.

Florije Boshnjaku – Qysh në fillim të Rregullores thuhet Drejtoria për Rini dhe Sporte ndërsa në fund të rregullores shkruan Kryesuesi Kuvendit. Librezat a i lëshon drejtoria apo departamenti i ministrisë së kulturës, pastaj kontratat për këtë vullnetar kush i nënshkruan, kush i përpilon , po ashtu a është e caktuar mosha deri në sa vjet mundë të jetë vullnetar. Pastaj tek neni 20 aktivitetet vullnetare duhet të jenë pjesë e planifikimit buxhetor komunal, pyetja ime është a i keni parë për vitin 2017 këto aktivitete dhe a ka buxhet nëse miratohet kjo rregullore.

Gardalin Shtavica – Kjo draft rregullore ka kaluar e tillë edhe në leximin e parë në kuvend, mendoj se kjo është dashur kur ka kaluar herën e parë në kuvend të ndryshohen. Sa i përket moshës aty është cekur që mbi moshën 16 vjeçare llogariten minoren, nuk ka ndonjë moshë të caktuar se kur përfundon aktivitetin si

vullnetar. Gjithashtu në rregulloren për vullnetarizëm është cekur se ato që nuk janë të cekura në rregullore vlejné sipas ligjeve të tjera. Sa i përket librezave ne i lëshojmë si drejtori e kulturës në kuadër të komunës së Rahovecit.

Kryesuesi - Kam disa propozime, mbase nenit 33 të shtohet në raste të konfliktit dhe mos përputhjes së kësaj rregullore me depozitat e ligjit dhe udhëzimeve administrative atëherë ligji vepron. Po ashtu tek neni 25 të shtohet që kjo rregullore mundet të ndryshohet me procedurat e njëjta ashtu siç është miratuar, gjithashtu në nenin 26 të shtohet që pas miratimit në kuvend kjo rregullore hynë në fuqi 8 ditë pas protokollimit në MAPL dhe pas shpalljes në veb faqe të komunës. E qesë në votim rregulloren për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në komunën e Rahovecit me këto propozime shtesë që i ceka më lartë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar Rregullorja për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit për komunën e Rahovecit.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për aprovimin e propozimit të Kryetarit të komunës për shpalljen e interesit të përgjithshëm, shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Kujtim Popaj – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, këtu kemi të bëjmë me një shpronësim të një parcele private e cila gjendet në zonën kadastrale Retij me nr.837/1 e gjithë sipërfaqja është 63 ari, ku janë dy bashkëpronar motra dhe vëllai Mehmet Reshat Kryeziu dhe Zerife Reshat Kryeziu. Qëllimi i shpronësimit të kësaj prone është ndërtimi i një shkolle, ne i kemi përgatit të gjitha dokumentet dhe pas aprovimit nga ana e juaj ne lëndën do të dorëzojmë në MF për vlerësimin e kësaj prone. Propozimi ka ardhur nga komuniteti i fshatit dhe arsimtarëve që punojnë

Florije Boshnjaku – Në lidhje me ndërtimin e shkollës besoj se të gjithë jemi pro dhe pajtohemi, mirëpo atë që kisha me propozim unë është që të na vije një arsyetim se kush ka propozuar që të ndërtohet kjo shkollë, a është e njoftuar Drejtoria e Arsimit sa nxënës janë në atë shkollë, pastaj cili është interesi i përgjithshëm. Në vendim shkruan miratohet propozimi i Kryetarit të komunës, po ashtu e pyes drejtorin dhe Kryetarin a ka komuna mjete që të paguaj për atë parcelë dhe për ndërtimin e kësaj shkolle, pastaj a është marrë pëlqimi ose deklarata e palëve që pajtohet për lëshimin këtij vendi për ndërtimin e shkollës, ne edhe herën e kaluar kemi pas një propozim por të gjithë e dimë se si ka kaluar ai propozim.

Kujtim Popaj – Kjo çështje është diskutuar në mbledhje të bordit aty është paraqit kërkesa nga drejtoria e arsimit, kryetari ka marrë qëndrim që është e nevojshme ndërtimi i kësaj shkolle. Buxheti në vitin 2015 është aprovuar nga ana e juaj për shpronësim menjëherë shumë të mjeteve prej 65,000.00 €, ndërsa çmimi sa kushton kjo pronë e përcakton organi i shpronësues nga MF, deklaratat i kemi marrë ne të autorizuar janë dy persona Ruzhdi Osman Kabashi dhe Fevzi Ramadan Thaqi. Për me i hekë të gjitha dyshimet sa i përket kësaj parcele e kam nxjerrë edhe historiatin e kësaj parcele dhe të gjitha të dhënat janë të sakta.

Fatmir Iska – Për mua ky vendim është në rregull, por ajo çka më intereson është çka do të bëhet më tutje me këtë shkollë ekzistuese ose çka do të bëhet me atë parcelë, po ashtu mendoj se është shumë sipërfaqja prej 63 ari për një shkollë në fshatin Retij nëse marrim parasysh numrin e banorëve dhe të nxënësve në këtë fshat. Kur do të bëhet planifikimi i mjeteve për ndërtimin e kësaj shkolle sa do të jetë vlera e sajë etj.

Hysni Gashi – Po ashtu edhe mua më intereson se çka do të bëhet me truallin e vjetër që gjendet shkolla ekzistuese, po ashtu mos kishte me qenë zgjidhje me racionale nëse ka hapësirë të mjaftueshme me prishë shkollën e vjetër dhe me ndërtuar një shkollë të re se sa me e bë shpronësimin e parcelave të reja.

Kryetari – Florije hiç mos u bënë marrak që po bëhesh monoton me merrje të fjalës, mua më pëlqen diskutimi që vazhdimisht je duke e iniciuar, por mua më vije çudi nga drejtorët se pse fillimin ose hyrjen nuk e përmendin ashtu si duhet, ajo pronë ku është shkolla ekzistuese nuk është pronë e komunës, ne nuk kemi mundur as me e bo renovimin e kësaj shkolle sepse duhet të kalojmë nëpër disa procedura, prandaj jemi detyruar që me e bë shpronësimin e një prone për ndërtimin e një shkolle, gjithashtu edhe ky vend nuk është aq shumë i përshtatshëm por është e vetmja mundësi. Parcela ndoshta është e madhe nëse flasim vetëm për objektin e shkollës por nëse flasim edhe për infrastrukturë përcjellëse në të ardhmen besoj që o të bëhet besoj se do të jetë e mjaftueshme.

Rasim Fazliu - Sa i përket shpronësimit të kësaj parcele unë plotësisht e mbështes propozimin e Kryetarit, është mirë që është duke u ndërtuar një shkollë e re gjithashtu mendoj se parcela është e mjaftueshme dhe nuk

e madhe sepse shkolla ka me pas edhe terrene sportive dhe shumë sende të tjera përcjellëse për gjitha nevojat. **Afrim Limani** – Ajo që më intereson mua është a ka implikime buxhetore në kuadër të këtij shpronësimi, drejtori gjatë bisedës e tha që çmimin e cakton organi mbikëqyrës nga ana e MF, konsideroj që ju paraprakisht e keni pas një bisedë me pronarët e kësaj parcele për çmimin, unë kisha me propozu që të ketë kritere sa i përket çmimit të jetë çmimi i tregut, gjithashtu të bisedohet nëse vije nevoja edhe të ndahet kjo parcelë.

Kryesuesi – Nëse ata nuk pajtohen me vlerën që ja cakton Komisioni i cili është në kuadër të MF atëherë shfuqizohet vendimi ne nuk kemi çka të bëjmë më tepër.

Selim Duraku – Ne e përkrahim propozimin e Kryetarit, çdo investim në arsim është për tu admiruar. Dua vetëm ta di kjo parcelë në çfarë vendi është kodrinor malor dhe a është e përshtatshme për shkollë.

Kujtim Popaj - Kam qenë në vendin e ngjarjes është pakës kodrinë besoj se i plotëson kushtet për ndërtimin e shkollës sepse sot kemi makineritë të fuqishme dhe atë vend e rrafshojmë dhe e rregullojmë ashtu si duhet.

Rukije Krasniqi – Mendoj se shkolla e tanishme nuk i plotëson kërkesat dhe nevojat për një mësimdhënie dhe një mësimnxënie të mirëfilltë, vendi që na njoftoi drejtori se është i një pozite kodrinore mendoj se duhet të mendojmë edhe për ujë dhe kanalizim, mos ndoshta do të kemi probleme me këto dy dukuri sepse gjatë procesit mësimor nëse mungon uji do të ketë vështirësi edhe në infrastrukturën shkollë.

Xhafer Bytyqi - Nëse komuniteti ka propozuar dhe nëse pronarët janë pajtuar me e liru pronën nuk e besoj se kemi nevojë ne me e diskutu se a është në rregull apo jo sepse në fund të fundit komuniteti ka me i dërgu fëmijët e vetë në atë shkollë. Po ashtu diskutimi që është bërë për madhësinë e sipërfaqes mendoj se nuk është në rregull sepse kjo madhësi është diku 19 ari ma e vogël se sa një fushë futbollit, prandaj sipas mendimit time jo që është e madhe por është e vogël për ndërtimin e një shkolle ashtu si duhet me të gjitha standardet.

Sinan Ejupi – Sa i përket këtij propozimi nëse ju si ekzekutiv e keni parë se është e nevojshme ndërtimi i një shkolle dhe ky vende është i përshtatshëm për mua është në rregull, sa i përket malësisë pajtohem me kryetarin kur thotë se shkolla ka nevojë për planifikime të tjera shtesë, pra unë jam pro këtij vendimi.

Kryesuesi – E qes në votim Propozimin e Kryetarit për shpronësimin e kësaj parcele në fshatin Retij për ndërtimin e shkollës fillore: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i kryetarit për shpronësim të parcelës në fshatin Retij. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për aprovimin e propozimit të Kryetarit të komunës për sigurimin

e tokës urbane për qëllime të interesit publik.

Kujtim Popaj – Është propozim i Kryetarit që ka të bëjë me këmbimin e pronës, parcelat të cilat duhet të këmbehen janë në qytetin e Rahovecit dhe janë afër njëra me tjetrën, pronarit të parcelës i mirët një sipërfaqe prej 49 m². Këmbimi i këtyre parcelave bëhet me qëllim të hapjes së një rruge sepse rruga ekziston dhe është e hapur por vetëm në fund ku gjendet kjo parcelë është e mbyllur, prandaj për të qen rruga e hapur na nevojitet edhe kjo parcelë prej 49 m². Komuna i ofron parcelën me nr. 424 me një sipërfaqe 82 m².

Kryetari – Rruga që tash është e hapur nuk është e shpronësuar njerëzit kalojnë aty por rruga prapë e them nuk është e shpronësuar, kam biseduar me personin e kësaj parcele, komuna e ka një parcelë aty afër prandaj ai ka propozuar që me ja kompenzu në mënyrë që rruga me qen legjitime dhe publike.

Fatmir Iska – Unë sa e di kjo rrugë është e hapur dhe aty kalojnë, mendoj se është në rregull që të jepen 82 m² për tu marrë 49 m² për rrugë sepse ka raste që edhe trefishi jepet për një rrugë, është mirë që po bëhet hapja e rrugës unë jam pro këtij propozimi. Por nuk pajtohem shumë me mënyrën se si është bërë vendimi për këtë rrugë, tek pika 3 thuhet: Miratimi i propozimit të Kryetarit është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcelat tjera komunale të përshtatshme për realizimin e projektit infrastrukturor, mendoj që nuk ka pas nevojë kështu të formulohet. Kishte me qen mirë që në atë kërkesë pasi që të kryhet procedura e shpronësimit të regjistrohesh në emër të komunës në mënyrë që nesër të mos na dal ndonjë problem.

Florije Boshnjaku – Pajtohem me ato që i tha Fatmiri sa i përket kësaj pike, por diçka nuk e kam të qartë tek neni 4 thuhet: Para shpalljes publike të vendimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private komuna do të paraqesë kërkesë për vlerësim të pronës private të paluajtshme. Pyetja ime është pse ne me paraqit kërkesë në ministri kur ne sot jemi duke ja dhënë pronën.

Kryesuesi – Këto gjëra janë të rregulluara me ligje, vlerësimin e bënë komisioni që është pranë MF kurse komuna është e obliguar që ti i respektoj ato.

Rasim Fazliu – Është mirë që është marrë kjo iniciativë që rruga të jetë legale dhe pronë publike në mënyrë që të gjithë të tjerët që nuk kanë pas qasja të kanë qasje në rrugë. E mbështesë këtë propozim të Kryetarit ndërsa organet tjera që janë për vlerësim të pronës le ti marrin qëndrime të veta.

Bahtjar Hoti – I kam dy propozime, e pari është për kolegët nëse e kanë mendimin e njëjtë si të kolegut që ka marrë fjalën para tij nuk ka nevojë të na merë kohë që të thotë pajtohem edhe unë. E dyta Nënkryetari sapo e zbuloj një shkelje statusore, ku tha se me statut nr. protokollit 01 është i Kryetarit ndërsa neve na vije 01 nga kuvendi gjithmonë, pra dua ta di kush është duke e bërë shkeljen statusore këtu sipas nënkryetarit shkeljen është duke e bërë kryesuesi.

Kryesuesi – Mundë të jetë bërë ndonjë gabim në statut sepse nr. protokollit 01 e ka Kuvendi sepse një herë vije Kuvendi e pastaj Kryetari. E qes në votim propozimin e Kryetarit për sigurimin e tokës urbane për qëllime të interesit publik: Konstatohet se me 1 abstenim dhe të tjerët pro është aprovuar propozimi i Kryetarit për sigurimin e tokës urbane për qëllime të interesit publik. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të Kryetarit të komunës për dhënien e pronës së paluajtshme në Shfrytëzim.

Fehim Fetoshi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Komuna e Rahovecit i ka disa prona në vende të ndryshme të cilat janë në pronësi dhe në menaxhim të komunës. Sot këtu i kemi 4 parcela në propozim për dhënie, ne kemi palë të interesuar të cilat dëshirojnë që këto prona të i marrin dhe të i punojmë. Bazuar në ligjin për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, ne e kemi marrë parasysh nenin 4 ku janë parimet e dhënies së pronës së paluajtshme komunale, këtu janë diku 8 parime dhe ne i kemi marrë parasysh këto 8 parime që do ti përmendi: Parimi ligjshmërisë, i efikasitetit, trajtimi barabartë i palëve, transparenca, rruajtja dhe garancia e interesit publik, rruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, rruajtja e karakteristikave dhe vlerave unike të pronës dhe rruajtja e mjedisit. Mendoj se nëse ju merrni vendim që për këto prona të shpallet ankand i jemi në suazat e ligjit me gjitha këto parime. Ne po ashtu kemi bërë një verifikim mos ndoshta në këto prona të cilat janë në pronësi të komunës ka ndonjë problematik sepse kemi parë se për disa prona kanë disa telashe sepse disa fermerë kalojnë nëpër këto prona ndërsa disa të tjerë i kanë kërkuar në shfrytëzim këto prona, ne ku ka pas kesi raste kemi ikur dhe nuk i kemi sjellë këtu fare, pra këto prona që janë sot këtu në kuvend nuk kanë kurrfarë probleme janë të lira. Kam një propozim për plotësim të vendimit, tek parcela nr.4 të shënohet që gjendet në vendin e quajtur rimnik në zonën kadastrale Rahovec, gjithashtu propozoj që të shtohet në vendim që Komuna e Rahovecit gëzon të drejtën që në çdo kohë të revokoj vendimin dhe pronat të i kthej në posedim të saj.

Florije Boshnjaku – Nuk e pata të qartë propozimin që e dha drejtori për përmisim të vendimit që komuna kur e sheh të nevojshme mundet të e revokoj vendimin dhe të ja merre pronat, mendoj se duhet të thuhet që një muaj ose një vit më parë duhet të njoftohet pala që komunës i duhet kjo pronë sepse kryetari kur e bënë kontratën e bënë së paku për 10 vite dhe nuk mundemi na masë një muaj me i thane neve na kthe pronën sepse na nevojitet, janë disa rregulla që duhet të e respektojmë kontratën. Gjithashtu tek neni 7 thuhet: për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme, ne si komision nuk mundemi me u kujdes për këto prona është gabim formulimi i këtij neni, komisioni mundet të i caktoj vetëm kriteret, prandaj propozoj që të ndryshohet ky nen.

Fehim Fetoshi – Në kuptim të formulimit ndoshta keni të drejtë por edhe ju duhet të dini që komuna nuk merë vendime shkel e shko dhe për qejfi me ja marrë dikujt pronën, por komuna ja merë pronën vetëm në raste kur e sheh të arsyeshme dhe ka nevojë shumë të madhe për ato prona. Sa i përket pikës së 7 të vendimit edhe për mua është i palogjikshëm por kështu ka dalë nga zyra e kryesuesit sepse në propozimin time nuk është kështu.

Fatmir Iska – Mendoj se është një iniciativë e mirë që është duke u bërë kjo, sipas listës poseduese që e kam këtu jam duke e parë që këto toka gjinden në zonën ku punohen tokat, për mua është në rregull ky nen le të rinë sepse komuna e Rahovecit e gëzon të drejtën që në çdo kohë të revokoj vendimin dhe prona mundet të

kthehet në posedimin e sajë nëse nuk shfrytëzohet për qëllime të mira. Këto toka me siguri janë vjerina dhe komuna pse

komuna mos të përfitoj nga këto toka, vota ime është pro këtij propozimi.

Rasim Fazliu – Kam një pyetje për drejtorin, a ka ndonjë të interesuar për ti marrë këto toka për ti shfrytëzuar. Mendoj gjithashtu se nëse jepen këto prona dhe nëse punohen është shumë mirë për komunën sepse do ti rritet vlera atyre tokave.

Fehim Fetoshi - Komuna ka shumë prona por ne si komunë i japim pronat vetëm atëherë kur ka të interesuar, prandaj për këto katër prona kemi qytetar të interesuar, përgjigja jonë për ta ka qenë që ne këto prona do i qesim në kuvendin komunal dhe nëse kuvendi komunal jepe leje për dalje në ankand ju duhet të i përcillni procedurat dhe të konkurroni, ko ka qenë përgjigja jonë për personat e interesuar.

Kadri Dellova – Këto prona momentalisht a janë duke u shfrytëzuar nga ndonjë person dhe nëse janë duke u shfrytëzuar a i keni paralajmëruar ata persona sepse mos të vije deri tek ndonjë konflikt.

Fehim Fetoshi – Ne i kemi verifikuar të gjitha parcelat të gjitha janë të lira, vetëm njëra parcelë është pjesërisht e nxënë, por gjithashtu ai që e ka nxënë këtë parcelë më duke është njëri prej atyre që ka shpreh interesim për me marrë këtë parcelë, por kjo është çështje e ankandit se kush fiton ne nuk mundemi me e ditë.

Selim Duraku – Ne e pamë që këto prona do të jepen me afat të shkurtër deri n 10 vite, ndoshta këtyre tokave i duhet një afat pak më i gjatë që të kthehen në toka punuese sepse nuk e dimë se çfarë kategorie janë këto toka.

Fehim Fetoshi - Këto toka janë të kategorisë së 5, kryesisht janë për vreshta dhe grurë dhe shumë sende të tjera, por të interesuarit janë ata që i kanë tokat fqinjë tek këto parcela besoj se ata e dinë se për çka i nevojitet këto parcela dhe për çka munden me i shfrytëz ato parcela.

Hysni Gashi – Mendoj se kur marrim kësi vendime është mirë të ceket kur se a i jepet me kompensim apo pa kompensim.

Fehim Fetoshi – Këto prona do të jepen me ankand dhe në ankand dha aty është çmimi fillestar, pastaj verat nga ofertat të cilët ofertojnë.

Afrim Limani - Sigurisht se është një iniciativë e mirë nga ana e komunës që i jepe këto prona në shfrytëzim, desha të lidhëm për tek afati, prandaj konsideroj se afati prej 10 viteve është shumë, mos kishte me qenë ma mirë që te jetë 5-7 vite me mundësi vazhdimi, pse e them këtë është sepse njerëzit të cilët e kanë në shfrytëzim nuk do të jenë të interesuar të punojnë tokën dhe komuna do të ketë mundësi ta përcjellë sa a janë duke u punuar këto prona dhe nëse shihet se ai i punon këto toka atëherë jo për 10 vite por edhe më shumë mundemi të i japim këto prona.

Kryesuesi - Mbase ankandit kur të lidhet kontrata aty do të precizohen këto gjëra dhe nëse ai nuk e punon normalë është që komuna do të ketë të drejtë të ja merë.

Fehim Fetoshi – Afrim vetë fakti se këto prona jepen me ankand është që ne nuk mundemi me ja vazhdu atij pronën sepse kur të skedoj afati duhet të hapet prapë ankandi. Por nëse komuna e sheh të arsyeshme për shkëputje të kontratës atëherë mbase nenit të cekur më lartë ja ndërprejnë kontratën.

Xhihad Vuçitërna – Disa herë është përmendur që të futet një nen ku komuna ka të drejtë të ja merë pronën kur e sheh të nevojshme, për çfarë arsye komuna ka të drejtë të ja merë pronën a duhet të precizohet. Nëse jepet me ankand publikë për 10 vite dhe ai i paguan komunës për atë pronë është problem i atij a e punon apo jo ai tokën për këto 10 vite, komunës ai po ja paguan qiranë.

Fehim Fetoshi – Komuna merë vendim për marrjen e pronës vetëm nëse e sheh të arsyeshme, gjithashtu edhe në kontratë do të precizohen shumë gjëra.

Rukije Krasniqi - A kanë të drejtë të aplikojnë klubet ose OJQ për me i përfitu këto toka për me i shfrytëz për nevojat e tyre.

Fehim Fetoshi – Ligji e thotë kështu, kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat fizik dhe juridik. Pra çdo klub ose shoqatë që është e regjistruar ka të drejtë të aplikoj në ankand.

Xhafer Bytyqi – Jam interesuar personalisht për këto prona, këto prona ishin të gjitha lugina të pa shfrytëzuara nga askush mua më gëzon fakti se ka qytetar që janë të interesuar që ti marrin ato prona dhe ti shtinë në rend të punës, mendoj se nuk kemi asnjë arsye mos me i përkrah këto propozime.

Kryesuesi – E qes në aprovim propozim vendimin e Kryetarit të komunës për dhënien e pronës së paluajtshme në Shfrytëzim me propozimin që neni 7 i vendimit të largohet aty ku shkruan komisioni vlerësues por të shtohet drejtoria për bujqësi : Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar propozim vendimi i Kryetarit të komunës për dhënien e pronës së paluajtshme në Shfrytëzim. Kalojmë në pikën e radhës:

8. Informim lidhur me shlyerjen e obligimeve të mbetura nga shfrytëzuesit e pronës komunale.

Këtu kemi të bëjmë me disa prona të cilat janë dhënë me ankand publikë, ku Kuvendi i Komunës ka marrë vendim që ti falë me 20 % të borxhit të mbetur, vendimi i Kuvendi është ende në fuqi dhe është shumë i qartë i mbetet vetëm ekzekutiviteti që ta respektojë vendimin e kuvendit. sot drejtori do ju jepe vetëm një informatë për gjendjen e këtyre kompanive të cilët e kanë pronën e komunës në shfrytëzim.

Avdullah Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, është normale që drejtoria në bazë të vendimit të Kuvendit me e përcjellë dhe me i monitoru këto kontrata. Ka vetëm një ndryshim të gjendjes tek Frigo stari, ky operator ka paguar 9,000.00 € dhe saldo e mbetur është 12,825.00 €, po ashtu është zotuar se këto obligime do ti kryej kohë pas kohe. Nëse flasim për biznese prodhuese të cilët punësojnë të ritë dhe nëse flasim për rritje ekonomike unë kisha kërkuar nga ju që ky vendim të shtyhet për këto biznese, pra të i jepet një afat tjetër të cilin do ta caktoni ju si anëtar të Kuvendit. Ndërsa sa i përket Hotel Parkut SH.P.K – Moderne nuk kemi pas asnjë pagesë dhe vlera e borxhit është 28 mijë e më tepër, këtu para meje e kam një kontratë që është lidhë në mes komunës dhe SH.P.K – Moderne në vitin 2013 për 15 vite. Ne të gjitha bizneset i kemi njoftuar për borxhin që e kanë komunës, po ashtu janë njoftuar edhe me vendimin e Kuvendit Komunal. Kërkesa e imja dhe e ekzekutivitetit është që të i zgjatet afati këtij vendimi pra të i japim edhe pak kohë këtyre bizneseve për me e pagu borxhin, mbasi këto biznese kanë edhe të punësuar.

Kryesuesi - Nëse nuk ka pas kërkesa nga operatorët për shtyrje të afatit për pagesë unë nuk e di se pse duhet të dilni me propozim, nëse kanë pas ata interes për shtyrje të afatit ata është dashur që një kërkesë të ja adresojnë kuvendit të komunës.

Avdullah Kryeziu – Kam një propozim në mbledhjen e fundit të mbajtur të ekzekutivitetit 20.06.2016 është kërkuar që të bëhet zëvendësimi dhe plotësimi i vendimit të komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, pra komisioni i ofertave, të gjithë e dini se z. Lulzim Haska ka dhënë dorëheqja, kryetari në këtë komision ka propozuar nga ekzekutiviteti z. Fehim Fetoshin Drejtorin e Bujqësisë.

Rasim Fazliu – Edhe unë jam i mendimit që nëse këta pronarë të këtyre bizneseve kanë kërkuar që të shtyhet kërkesa duhet ta bëjnë një kërkesë në kuvend në mënyrë që ne ti shtyjme afatin për pagesë, është mirë që të i japim edhe një shanse bizneseve mendoj se edhe komunën nuk do të ketë ndonjë dëm të madhe nëse ia shtyjme afatin sepse ne jemi për të i ndihmuar bizneset, por edhe bizneset duhet të kenë përgjegjësi ndaj obligimeve që duhet të i kryejnë karshi komunës.

Florije Boshnjaku – Drejtori duhet të kërkojë që të ndryshohet vendimi e jo të shtyhet afati sepse ky vendim është në fuqi. Gjithashtu propozoj që edhe këtyre 3 bizneseve të i falim 50 % të borxhit si atyre tjerëve që i kemi falur nga 50 % me një afat shtesë prej 3 muajve, por mos të harrojmë se ky vendim duhet të ndryshohet.

Bahtjar Hoti - Duke pasur parasysh numrin e të punësuarve në këto biznese është mirë që ti falim edhe këtyre 50 % të borxhit nëse dëshirojmë me t vërtet me i ndihmu bizneset.

Kadri Dellova – Nga këto 3 biznese publike njëri prej tyre ndryshon sepse është prodhues e ky është Frigo Stari, ky biznes prodhues që është ma e mira i ka paguar 9,000.00 €, ndërsa Xeni Commerce dhe Moderne janë biznese që kanë afarizëm mjaftë të suksesshëm nuk kanë paguar asnjë centë komunës. Propozimi imë personal është që Frigo Stari pasi i ka lëvizur gjërat për të mirë me ja zbritë borxhin me 50% falje.

Selim Duraku – Mendoj se nuk është mirë të shkojmë me seleksionime të bizneseve nëse dëshirojmë të marrim ndonjë vendim është mirë të marrim për 3 biznese. Ka mundësi që në vitet e kaluar këto biznese i kanë bërë pagesa mujore ashtu si i kanë pas obligim komunës dhe tash nëse një kompani private nuk i paguan një

kohë komunës borxhin dhe vije pastaj dhe paguan një shumë fikse komunës dhe i falet 50 % të borxhit mendoj se është e padrejtë edhe për biznese të tjera private.

Afrim Limani – Këtu i kemi 3 biznese të ndryshme të cilat mirën me veprimtari të ndryshme, ne jemi duke parë se ka pas një pagesë të mirë nga Frigo Stari, pastaj edhe Xeni Commerce nuk e ka ndonjë shumë të madhe të borxhit dhe besoj se do ta shlyej. Mua më çudit fakti se si SH.P.K Moderne ende nuk ka bërë kurrfarë pagese, unë propozoj që ti shtyhet afati për pagesë deri në 6 muaj pra deri në fund të vitit 2016, në mënyrë që këto biznese të kenë hapësirë të i paguajnë borxhin.

Nënkryetari – Moderne nuk ka ardhur në këtë situatë për shkak se nuk ka dashur të i paguaj borxhin komunës, mirëpo dikush nga punëtorët e vetë e ka konsultuar gabimisht sepse ai mendon që qiranë që duhet të paguaj për shfrytëzim të hotelit mundë të zbërthej në atë kur ka qenë para 3 viteve në bazë të një ndërmarrje të specializuar që e ka bërë vlerësimin e investimeve në atë hotel dhe atë vlerësim e ka pranuar ky Kuvend. E keqja më e madhe është se deri a ka qen drejtor i ekonomisë Musa Cena nuk ja ka bërë prerjen e borxhit Hotel Parkut, por e keqja tjetër është që edhe ne nuk jemi duke e bërë një prerje të tillë që sa është amortizimi, sa ka pas borxhe të mëhershme dhe sa mbetet për të investuar në kontratën që e ka. Edhe një sugjerim ju mundë të votoni për falje 50 % por me propozimin e kujt, me propozimin e një delegati mendoj se nuk është në rregull.

Hysni Gashi – Jam duke u befasuar në qoftë se bizneset kanë pas interes me bë kërkesë për me ju zbritë borxhi, jam i habitur se pse nuk janë duke e përcjellë afatin që ju është dhënë sepse çdo punë bëhet me një afat të caktuar dhe pak para se të kaloj ai afat të njëjtë nëse nuk kanë pas mundësi të e paguajnë obligimet sipas vendimit të bëjnë një kërkesë të re në Kuvend në mënyrë që ne me marrë një vendim të ri për shtyrje të afatit i cili do ta shfuqizon vendimin paraprak, duhet të jemi më korrekt me procedura, mendoj se ne sot jemi duke biseduar jashtë normales jemi duke biseduar për diçka që i ka kaluar afati dhe ne si kuvend nuk kemi marrë kurrfarë vendimi tjetër.

Rexhep Oruçi – Kryesues shumë mirë e pati nënkryetari rreth çështjes së SH.P.K – Modernes, ky biznes ka pas mundësi të paguaj borxhin por ai pritke që ti bëhet barazimi ose të i bëhet një analizë e gjendjes. Kishte me qen mirë që të formohet një komision kryesues i komisionit le të jetë Drejtori i Ekonomisë dhe një financier dhe tamam le ta zbatojnë vendimin e vitit 2013 kur ju kanë pranuar ato investime, pra gjërat duhet të harmonizohen dhe normal që ai pastaj duhet të i paguaj obligimet.

Kryesuesi – Pronari i SH.P.K –Modernes duhet të merë një përfaqësues ligjor dhe të vije në Komunës dhe të e zgjidhë problemin e jo komuna me ja zgjidhë atij problemin.

Avdullah Kryeziu – Ne e kemi një kontratë të nënshkruar me 25.05.2013 për 15 vite, para nënshkrimit të kontratës organi është dashur të mirët seriozisht me vendimin të cilin e ka pru Patrija Grup një kompani që e keni përcaktuar ju, pra kuvendi ja ka njohtë vlerën e investimeve prej 1,287,000.00 €. Fatkeqësia e kontratës është se neni 13 thotë: Dhënësi garanton se çmimi i shfrytëzimit të objektit hapësira e brendshme dhe e jashtë nuk do të zbatohen – zbërthehet në qira por do të paguhet çdo muaj për shfrytëzim, investim konsiderohet çdo pjesë që ndërtohet dhe riparohet për objekte dhe që është paraparë në projektin ideor investues e që është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, mjetet e investuara nuk do të zbërthehen në qira. Pra kjo është kontrata e fundit qëwë ne nuk po mundemi me vepru. Sa i përket pyetjes së Florije duke u bazuar në nenin 27 të rregullores komunale për taksa tarifa dhe gjoba thuhet qartë: të gjitha subjektet të cilat nuk i përgjigjen pagesës së taksave, tarifave ngarkesave dhe gjobave komunale të paraparë meqë rregullore do të kërkohet ekzekutimin i dhunshëm nëpërmjet gjykatës kompetente dhe përmbauesve privat.

Xhafer Bytyqi – Sa jam duke parë këtu është në pyetje përmbyllja e kontratës paraprake të Modernes, mendoj se duhet të shikohet se me çfarë procedure duhet të përmbillet kjo kontratë për me ardhë deri tek vendimi tjetër për borxhin e ri. Është mirë që të njoftohet pronari i biznesit që të vije në Komunë dhe të barazohet për kontratën paraprake, kurse kontrata e re i ka rregullat e veta. Sa i përket zbritjes së borxhit në 50 % mendoj për deri sa nuk ka pas kërkesë nga bizneset nuk është mirë që ne si kuvend të zbresim borxhe.

Rasim Fazliu – Në kontratën e fundit a shkruan diçka për kontratën paraprake, unë jam për atë që thonë shtëpi pa derë nuk ka pra të zgjidhet ky problem një herë e përgjithmonë e jo ta lëmë zvarrë këtë problem.

Avdullah Kryeziu – Ajo kontratë ka skaduar dhe në aspektin ligjor ajo nuk prodhon efekt juridik, ndërsa në kontratën e re nuk janë të precizuara ato që i tha kryesuesi, nënkryetari dhe Rexhepi. Sa i përket kontratës së parë ajo është shumë ma e precizuar se sa kontrata e dytë.

Rukije Krasniqi – Drejtori e tha se kontrata e parë ka qenë shumë më e precizuar, ajo kontratë ka qenë bërë nga administratori në atë kohë, kontrata nuk ka pas as nënshkrim e ju thoni se ka qen ma e mirë.

Kryesuesi – Administratori Antoni Tompson që ka qenë në atë kohë nuk e ka ditë gjuhen shqipe, ai kontratën e ka nënshkruar në gjuhën angleze ndërsa në gjuhen shqipe e ka nënshkruar i ndjeri Myrvet Durguti.

9. Zëvendësimi dhe Plotësimi i Komitetit për Politik dhe Financa dhe Komitetit për Shërbime Publike Komunale me anëtar të ri.

Meqenëse kanë qen nga grupi i PDK-së e lusë kryetarin e grupit të këshilltarëve të PDK-së që të jep dy propozimet.

Rasim Fazliu – Në vend të Beatrisa Demirit në KPF propozojmë Qazim Qesken, kurse në Komitetin për Shërbime Publike në vend të Ejup Kabashit propozojmë Elvedina Canën.

Kryesuesi – E qes në votim Propozimet: Konstatoj se në mënyrë unanime janë aprovuar propozimet e Rasim Fazliut që Qazim Qeska të jetë anëtar i ri i KPF-së dhe Elvedina Cana anëtare e re e Komitetit për Shërbime Publike.

Me kaq përfundon mbledhja e sodit, Ju falënderoj për prezencën dhe kontributin e dhënë për këtë mbledhje shihemi në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 13:30

Procesmbajtësi
Skender Hamza

K R Y E S U E S I
Nahit Elshani